

VENDIM
Nr. 749, datë 1.12.2022

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400 kv ELBASAN 3”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtimi i nënstacionit 400 kv Elbasan 3”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 13 475 622 (trembëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 13 475 622 (trembëdhjetë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy) lekësh, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
 8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sh.a., për pasuritë e shpronësuara.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I “NËNSTACIONIT 400 kv ELBASAN 3”

Nr.	Pronësia										Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale e pronës m ²	Sip. e pronës që shpronësohet m ²	Çmimi i shpronësimit në lekë/m ²	Vlera e shpronësimit lekë/arë	
Bashkia Elbasan											
Fshati Kryezjarrth											
1	Feim Avdul Zeneli & Alie Begdash Zeneli			2296	44/1/3	arë	2500	2,500	222	555,000	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
2	Mirela	Preni	Merdani (Çakalli)	2296	44/1/4	arë	2000	2,000	222	444,000	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
3	Nosi	Vasil	Biba	2296	44/2	arë	4000	4,000	222	888,000	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
4	Englantina	Josif	Ranxha	2296	44/3/1	arë	1625	1,625	222	360,750	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
5	Kozeta	Josif	Kuqi	2296	44/3/2	arë	1625	1,625	222	360,750	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
6	Ndriçim	Marthe	Tollumi	2296	44/4	arë	3792	3,792	222	841,824	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
7	File	Tasi	Zela	2296	44/5	arë	2831	2,831	222	628,482	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Feride	Dylber	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Ervin	Jani	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Mirjan	Jani	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Aferdita	Vasil	Sollaku								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Dhimiter	Vasil	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Vangjeli	Vasil	Xhija								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Jani	Vasil	Zela								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
8	Dhimiter	Vasil	Zela	2296	44/6	arë	2700	2,700	222	599,400	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
9	Thoma	Ili	Bica	2296	45/2/1	arë	2900	2,900	222	643,800	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
10	Jorgji	Tasi	Bica	2296	45/3	arë	2750	2,750	222	610,500	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
11	Foti		Ranxha	2296	45/4	arë	4125	4,125	222	915,750	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
12	Thoma	Spiro	Roçi	2296	45/7	arë	3539	3,539	222	785,658	Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Afërdita	Grigor	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Gentian	Thoma	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Alfred	Thoma	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Eduard	Thoma	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan
	Ervin	Thoma	Roçi								Konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Elbasan

